



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni Pranvror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 07/2010

Prishtinë më 16. 02. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjës së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, dhe Mufëra Şinik.

Munguan: Slobodan Petroviq, Nerxhivane Dauti, Kaqusha Jashari dhe Qamile Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: Avdi Kamerolli dhe Nazim Rahimi - MTPT, Nora Sahatçiu – UNDP, Lejla Selmi – OSBE , Visar Ramaj – KDI dhe Lumnije Murati – ZPRK.

Stafi Mbështetës: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i d i t ë s :

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të datës 09. 02. 2010 ,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbime postare,
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes më 09. 02. 2010

Kryetarja e Komisionit konstatoi se miratohet procesverbali i mbledhjes më 09. 02. 2010 pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Projektligjit për shërbime postare

Kryetarja – I njoftoi anëtarët e Komisionit se kryesuesi i Grupit të punës i Projektligjit për shërbime postare, Zef Morina, paraqet Raportin me amendamente.

Zef Morina – Theksoj se Grupi i punës e ka shqyrtuar Projektligjin për shërbime postare dhe i ka miratuar amendamentet. Pastaj vazhdoi me prezantimin nga amendamenti 16 , në të cilin kishte mbetur nga mbledhja e kaluar, që i paraqiti për diskutim dhe miratim.

Amendamenti 16 ndryshon nenin 29, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, paragrafët 2 dhe 3 hiqen; amendamenti 17 riformulon nenin 30, paragrafin 1; amendamenti 18 ndryshon nenin 32, paragrafët 2.4, 2.1 dhe 3.2; amendamenti 19 ndryshon nenin 35, paragrafët 1 dhe 2; amendamenti 20 ndryshon nenin 37 paragrafin 1 dhe nenin 39, paragrafin 3; amendamenti 21 ndryshon nenin 44, paragrafi 2 dhe shtohen dy paragrafët e rinj 4 dhe 5; amendamenti 22 ndryshon nenin 48.

Avdi Kamerolli (MTPT) – Kërkoj që propozimi në amendamentin 16 në nenin 29, te nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, për kohën e eliminimit të shkeljeve të evidentuara nga 3 muaj, të ndryshohet në 30 ditë. Po ashtu në amendamentin 19, të nenit 30, paragrafët 6.1 dhe 6.2, ndryshimi i propozuar për ditën e pranimit nga “D+3 ose 5 të jetë D+n” të mos kalojë, por të mbetet si në Projektligj.

Propozimet e MTPT - së u miratuan nga Komisioni.

Zef Morina – Propozoi të hiqet amendamenti 11, për ndërhyrje në nenin 14, andaj neni 14 mbetet si në Projektligj.

Përfundim

- I. Më vërejtjet e cekura amendamentet u miratuan në tërësi;
- II. Autorizohet Njësia mbështetse për hartimin e Raportit me amendamente.

Ethem Çeku – Kishte vërejtje parimore lidhur me miratimin e amendamenteve përmbajtësore gjatë shqyrtimit të projektligjeve në komision, e që procedohen për miratim në seancën plenare, ku po ndodh të paraqiten dilema nga deputetët e tjerë. Ai

bëri thirrje që komisioni të ketë një përkushtim dhe koordinim më të mirë që sa ma pakë të ketë dilema (mundësisht të ketë koncensus) rreth amendamenteve të natyrës përmbajtësore .

IV. Të ndryshme

a) Kërkesa për vazhdimin e mandatit – rizgjedhjes në Komisionin Kosovar të Konkurrencës.

Kryetarja – I njoftoi për kërkesën që i ka arritur Komisionit për rizgjedhjen e një kandidati për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- Propozimi në rrugën zyrtare duhet të vijë në Komision nga Qeveria, sipas Ligjit të Konkurrencës.

b) Asistenca e UNDP- së me ekspertë për Komisionin

Kryetarja – njoftoi se UNDP- ja ka afruar një asistencë me ekspertë të fushës për nevoja të Komisionit.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- Komisioni mirëpret asistencën e UNDP- së për ekspertë për nevoja të Komisionit;
- Komisioni kërkon që ekspertët të jenë të fushave përkatëse, për shkak të specifikave të Komisionit.

c) Mbledhja e radhës

Kryetarja – Propozoi që në mbledhjen e radhës, si pikë e rendit të ditës, të jetë në shqyrtim Raporti i Projektligjit për shërbimet postare.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. Në mbledhjen e radhës të jetë në shqyrtim Raporti i Projektligjit për shërbimet postare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani